

REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E SHITES

KONTRATË

Komuna Shtime Rr. „Tahir Sinani „, tel. 0290-389-016-131që e përfaqëson Drejtori i Prokurimit Muhadin Halili në njëren anë;

dhe

OE,, Migrant Ing ,, shpk nga Prishtina që përfaqësohet nga „Granit Hyseni i autorizuar telefoni: 044-712-714 ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për:

„ Ndërtimi i Lapidarit (Bustit) Ahmet Shtimja në shesh , Shtime

Nr. i Prokurimit 617-21-4243-2-2-3

Nr. i brendshëm 617-2021-052-423

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës : Realizimi i bustit kushtuar Ahmet Shtimes duhet të jetë në harmoni sipas kërkesave të specifikuara . Shprehja figurave artistike e bustit duhet të integrohet fuqishëm dhe të korrespondojë vizuelisht me hapsiren e sheshit në të cilën planifikohet të vendoset figura në bronzë.

Lartësia e bustit duhet të jetë (Oriëntuese) minimumi 0.85 cm deri 1.20 cm .Materiali i fortë përfundimtar i bustit është bronzi . Në çmim duhet të kalkulojnë të gjitha shpenzimet : Punimi i bustit , përgaditja e bazamentit , transporti , siguri gjatë transportit dhe vendosja në postament. Realizuesi i bustit duhet të shënoj , gaveroj edhe emrin mbiemrin datën e lindjes dhe datën e vdekjes.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me nënshkrimin e kontratës nga të dy palët, dhe përfundon më datë 10.08.2022

1.3 Vendi i vendosjes së bustit do të jetë në Qytetin e Shtimes, Sheshi „Ahmet Shtimja,, , i cili do të vendoset në bashkëpunim me menaxherin e kontratës dhe subjektet relevante të komunës . Data e vendosjes së bustit do të bëhet në kordinim me organet kompetete komunale si dhe menaxherin e kontratës . OE është i obliguar që bustin t'a ketë gati brenda 100 ditëve nga nënshkrimi i kontratës

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi i përgjithshëm i kontratës për ndërtimin e shtatoreve dhe pllakes përkujtimore shprehur me numra është **29,889.00 €; ose shprehur me fjalë Njëzetë e nëntë mijë e tetëqindë e tetëdhjetë nëntë Euro.**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Në çmim të kalkulohen të gjitha shpenzimet: punimi i bustit, përgaditja e bazamentit lapidarit ,(bustit) transporti, sigurimi gjatë transportit dhe vendosja në postament.

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Pagesa do të bëhet si në vijim: Pagesa do të bëhet nga buxheti i vitit 2021 dhe 2022 në bazë të situatave (Çertifikatave) të verifikuara nga Menaxheri i kontratës.

OE duhet të sjell këto dokumente për pagesën e fundit :

1.Garancioni për (12 muaj)2.Raporti i pranimi teknik nga komisioni.3.Situacioni përfundimtar .4.Fatura e rregullt.5.Raport nga mbikqyrësi për përfundimin e bustit .

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i punimit të shtatores duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit dhe të paraqitura në buxhetin e dorëzuar me rastin e aplikimit në konkurs projektimi.

6.2 Nëse komisioni për pranim konstaton se kontraktuesi nuk i është përmbajtur kushteve për ndërtimin e shtatores dhe nuk i ka tiparet që janë paraqitur në buxhet nuk do të pranohet dhe nuk do të lejohet vendosja dhe nuk do të paguhet.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimi të bustit ,furnizuesi është i obliguar të dorëzojë sigurimin kualitetit të punës dhe materialit për punimin e shtatores.

Kontraktuesi do të garantojë për materialin e përdorur se do të jetë rezistencë ndaj kushteve klimatike me garancion bankar ose kompani të sigurimit të rregullt, 1 vjeçar pas pranimit teknik në vlerë prej 10% të vlerës së kontratës.

Kontraktuesi është përgjegjës për bustin deri në momentin e përfundimit d.m.th zbulimit të bustit që njëherit konsiderohet pranim i punës së kryerë.

Neni 8 Sigurimi i ekzekutimit

Kontraktuesi do të paguj sigurimin e ekzekutimit në vlerë prej 10 % të shumës së përgjithshme të kontratës për një periudhë prej 12 muajve

Neni 9 Vonesat në ekzekutim

9.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së punimeve të shtatoreve dhe të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 10 Inspektimi dhe testimi

10.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të Inspektojë, kontrollojë, mase dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, ndërtimit të shtatores që do të ndërtohen për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 11 Nën-kontraktimi

11.1 kontraktuesi nuk ka të drejtë të nënkontrakttojë ndërtimin e shtatores , shtatoren është i obliguar t'i ndërtojë vetë, sipas marrëveshje së konzorciumit. Kontraktuesi nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

12.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res-judikata; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 13 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

13.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 14 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

14.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykata thelore në Lipjan në pajtim me ligjin e Kosovës.


Neni 15 Komunikimi

15.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e mail ose me dorë.

Kjo kontratë është hartuar në gjuhën Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Granit Hyseni	Emri:	Muhadin Halili
Pozita:	I autorizuari	Pozita:	Drejtor i Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	11.08.2021	Data:	11.08.2021
Vula:		Vula:	

PARAMASA DHE PARALLOGARIA					
Projekti: Buznemeuli i Lapidarit të Bustit të heronit AHMET SHTIMJA					
Investitori: Komuna Shtime					
Vendi i ndërtimit: Sheshi në Shtime					
Nr.	Përshkrimi i punës	Njësia	Sasia	Cmimi (€)	Gjithësej (€)
I PUNËT PREGADITORE DHE PUNËT E DHEUT					
1.1	Punët përgaditore për fillimin e punimeve. Rregullimi i zyrave të përkohshme. Sigurimi i punës me shënjat adekuate.	paushall	1.00	150.00	150.00 €
1.2	Matjet gjeodezike për pjesën ku është parapare ndërtimi, më të gjitha punët përcjellëse.	paushall	1.00	100.00	100.00 €
1.3	Gërmimi i hapësirës që parashihet për ndërtimin e bazamentit dhe pllatoe ku do të vendoset lapidari bustit.	m3	1.00	30.00	30.00 €
1.4	Furnizimi, transporti, vendosja dhe ngjeshja e pjesës nën themelin e bazamentit të lapidarit bustit, me zhavor fraksion 0-31.5 mm me trashësi t=30 cm, nivelizimi dhe ngjeshja e tij.	m3	0.30	30.00	9.00 €
Totali Punët përgaditore dhe punët e dheut					289.00 €
II PUNËT NDËRTIMORE					
II.1 Punët e betonit					
2.1	Furnizimi dhe punimi i themelit dhe bazamentit të lapidarit të bustit me material të betonit C 25/30 si dhe furnizimi dhe montimi me granit natyral sipas projektit nga organi mbikqyrës, ose guri masiv (i Arbërit, Prilepit ose ekuivalent) forma e punimit të këtij pozicioni do të zgjidhet nga organi mbikqyrës me dimensionet si në projekt. Në çmim të parashihet shkrutuarja e emrit mbiemrit si dhe datat e lindjes dhe vdekjes së heroit	m³	1.00	4,000.00	4,000.00 €
2.2	Demolimi, ruajtja dhe me pas rivendosja e kubezave të sheshit ekzistueso në hapësirën përreth lapidarit të bustit dhe ku do të vendoset ndriqimi dhe instalimi elektrik	paushall	1.00	900.00	900.00 €
Totali Punët e betonit:					4,900.00 €
II.2 PUNËT E ARMATURES					
2.1	Furnizimi, transporti, prerja dhe vendosja e armaturës me prerje si në projekt për themelin e bazamentit të lapidarit si dhe pjesëve tjera me beton.	kg	180.00	2.50	450.00 €
Totali Punët e armaturës:					450.00 €
Totali Punë Ndërtimore					5,350.00 €
III PUNËT ELEKTRIKE					
3.1	Furnizimi, transporti dhe montimi i reflektorëve në hapësirën e parapare me projekt.	copë	4.00	300.00	1,200.00 €
3.1	Furnizimi, punimi dhe funksionalizimi i sistemit elektrik nga ndriqimi publik i sheshit.	paushall	1.00	2,050.00	2,050.00 €
Totali Punët elektrike					3,250.00 €
IV PUNIMI I BUSTIT					
4.1	Realizimi i bustit kushuar (AHMET SHTIMJA) sipas kërkesave të specifikuara. Shprehja figurative artistike e bustit duhet të integrohet fuqishëm dhe të korrespondojë vizualisht me hapësirën e sheshit në të cilin planifikohet të vendoset figura në bronzë. Busti si koncept në veshet duhet të jetë shprehje artistike dhe figurative me të cilën kjo refleksion tiparet dhe personalitetin e (AHMET SHTIMJA) Kompozimi i bustit do të përfshijë pamjen figurative të (AHMET SHTIMJA). Lartësia e bustit duhet të jetë (orientuese) Minimumi 0.85m maksimumi 1.20 cm. Materiali i fortë përfundimtar i bustit është bronzi. Në çmim duhet të kalkulohej të gjitha shpenzimet: punimi i bustit, transporti, sigurimi gjatë transportit dhe vendosja në postament, realizuesi i shatës duhet të shenojë: Gaveroj edhe Emrin Mbiemrin, datën e lindjes dhe të vdekjes.	copë	1.00	21,000.00	21,000.00 €
Totali Punimi i Bustit:					21,000.00 €
REKAPITULIMI I PËRGJITHSHËM					
I. Totali Punët përgaditore dhe punët e dheut					289.00 €
II. Totali Punë Ndërtimore					5,350.00 €
III. Totali Punët elektrike					3,250.00 €
IV. Totali Punimi i Bustit:					21,000.00 €
TOTAL:					29,889.00 €

Emri i Kompanisë	Megranit Ing SH.P.K
Adresa e Plote	rr. Ilir Soba nr 5 Prishtinë
Përfaqësuar Nga:	Gresa Blakqori
Emri & Mbiemri	Drejtor
Pozita	22.07.2021
Nënshtkrimi	
Data	
Vula	



ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Policies me Nr. 96056

Për KK Shtimje

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të Migrant Ing SH.P.K.

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Ndërtimi i Lapidarit (Bustit) Ahmet Shtimja në shesh , Shtime**

Nr. prokurimit: 617-21-4243- 2-2-3 , Nr. brendshëm: 617-21-4243- 2-2-3

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **2,988.90€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **2,988.90€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 395 ditë kalendarike prej **11.08.2021** deri më **10.09.2022**

Data lëshimit: 11.08.2021

Nënshkrimi dhe yula e garantuesit

